



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.146

1 nëntor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 469 datë 13.10.2011	Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese 6559
Ligj nr.10 470 datë 13.10.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar 6563
Vendim i Kuvendit nr.130, datë 13.10.2011	Për lirimin nga detyra dhe emërimin e një anëtari të këshillit drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 6564
Dekret nr.7100 datë 11.10.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 6564
Vendim i KM nr.680, datë 5.10.2011	Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të menaxhimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik dhe të Komitetit të Auditimit të Brendshëm 6565
Vendim i KM nr.682, datë 5.10.2011	Për një shtesë në vendimin nr.472, datë 2.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e fondeve buxhetore, për vitin 2011”, të ndryshuar 6565
Vendim i KM nr.683, datë 5.10.2011	Për një shtesë në vendimin nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, të ndryshuar 6566
Vendim i KM nr.684, datë 5.10.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.627, datë 31.8.2011, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012” 6566

Vendim i KM nr.685, datë 5.10.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.391, datë 1.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social”, sh.a.”	6568
Vendim i KM nr.687, datë 5.10.2011	Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara	6568
Vendim i KM nr.688, datë 5.10.2011	Për një shtesë në vendimin nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar	6575
Vendim i KM nr.691, datë 12.10.2011	Për miratimin e dëshmipërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist	6576
Udhëzim i MASH nr.37, datë 23.9.2011	Për strukturën e vitit akademik 2011-2012 në institucionet publike të arsimit të lartë	6585
Udhëzim i MASH nr.38, datë 23.9.2011	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012.....	6586
Urdhër i MD nr.6386/1, datë 7.10.2011	Për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit	6588
Vendim i ERE nr.87, datë 26.9.2011	Për licencimin e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	6589
Vendim i ERE nr.88, datë 26.9.2011	Për licencimin e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	6590
Vendim i ERE nr.89, datë 26.9.2011	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Klos” si burim i rinovueshëm energjie	6591
Vendim i ERE nr.90, datë 26.9.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Malido Energji ” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	6592
Vendim i ERE nr.91, datë 26.9.2011	Për licencimin e shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et “Shemri” dhe “Mgulle”	6593
Vendim i ERE nr.92, datë 26.9.2011	Për shtyrjen e afatit të licencës nr.63 të dhënë me vendim të bordit të komisionerëve nr.89, datë 6.8.2008 të ndryshuar me vendimin e bordit të komisionerëve nr. 19, datë 8.3.2010 për “Albanian Green Energy”	6594

Vendim i ERE nr.93, datë 26.9.2011	Për shtyrjen e afatit të licencës nr.64, e dhënë me vendimin e bordit të komisionerëve nr.90, datë 6.8.2008 për “Biopower Green Energy”	6595
Vendim i ERE nr.94, datë 26.9.2011	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a. për transferimin e aseteve përkatësisht “Nënstacioni Lanabregas”, “Nënstacioni Bogovë”, “Nënstacioni Gjanc”, “Nënstacioni Bushat 110/20 kv”, “Rrjeti 20 kv Koplik”, “Nënstacioni Shkodër 110/20 kv”, “Nënstacioni Fier 110/20kv”, “Nënstacioni Gjirokastër”	6596
Vendim i KNSH nr.38, datë 19.9.2011	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”	6597
Vendim i KNSH nr.39, datë 19.9.2011	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë”	6598
Vendim i KNSH nr.40, datë 19.9.2011	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për përcaktimin e procedurave të konkurrit për ofrimin e shërbimit të formimit profesional të punëkërkesve të papunë nga persona juridikë/fizikë privatë dhe organizata jofitimprurëse”	6600
Vendim i KNSH nr.41, datë 28.9.2011	Për shqyrtimin e urdhrit nr. 120 datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundërshtëpërblim”	6602
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Evangjellos Feno Bineri	6609

LIGJ
Nr.10 469, datë 13.10.2011

PËR MBROJTJEN NGA RREZATIMET JOJONIZUESE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është kontrolli i ekspozimeve të publikut dhe të punonjësve, si dhe monitorimi i rrezatimeve jojonizuese, duke shfrytëzuar të mirat që vijnë nga përdorimi i tyre.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton masat që synojnë mbrojtjen e publikut dhe të punonjësve nga efektet dëmtoese në shëndet, si rezultat i ekspozimit të tyre ndaj rrezatimeve jojonizuese në intervalin e frekuencave 0-300 GHz.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Efektet dëmtoese shëndetësore” janë efektet biologjike, që kanë pasoja dëmtoese në gjendjen fizike, mendore ose të përgjithshme të njerëzve të ekspozuar, qofshin ato afatshkurtra ose afatgjata.
2. “Ekspozim ndaj rrezatimit jojonizues” është rrezatimi i një individi nga fushat elektrike, magnetike ose elektromagnetike.
3. “Ekspozim profesional” është ekspozimi ndaj rrezatimeve jojonizuese, që ndodhin gjatë punës me pajisjet e këtyre rrezatimeve.
4. “Ekspozim publik” është ekspozimi ndaj rrezatimeve jojonizuese që marrin individët ose publiku, përjashtuar ekspozimet profesionale e mjekësore.
5. “Kufizime bazë” janë kufizimet ndaj ekspozimeve të fushave elektrike, magnetike ose elektromagnetike, në bazë të efekteve shëndetësore të përcaktuara. Në varësi të frekuencës së fushave, madhësitë fizike, që përdoren për të përcaktuar këto kufizime, janë densiteti i rrymës (J), shkalla e përthithjes së energjisë specifike (SAR) dhe densiteti i fuqisë (S).
6. “Kufi ekspozimi” është kufiri i sipërm, i vendosur për ekspozimin e njerëzve ndaj rrezatimeve jojonizuese, me qëllim mbrojtjen e tyre nga efektet e dëmshme biologjike.



7. “Mbikëqyrje” është monitorimi i ekspozimit të individëve ndaj rrezatimeve jojonizuese ose monitorimi i burimeve që lëshojnë rrezatim jojonizues.

8. “Miratim” është miratimi i lëshuar nga trupa rregullatore, mbi bazën e një aplikimi për veprimtari me pajisje rrezatuese jojonizuese.

9. “Pajisja me rrezatim jojonizues” është çdo produkt i fabrikuar që prodhon rrezatim jojonizues.

10. “Pajisje elektromagnetike mjekësore” është çdo pajisje ose instrument që përdor fushën elektromagnetike për diagnostikimin ose kurimin e pacientëve që janë nën kontroll mjekësor.

11. “Rrezatim jojonizues (Fushë elektromagnetike)” është entiteti fizik që mbart ose ruan energjinë në hapësirë dhe që ushtron forcë mbi ngarkesat elektrike. FEM-ja përfshin fushat magnetike, elektrike ose statike, me frekuenca në intervalin 0-300 GHz.

12. “Veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues” është veprimtaria e personit fizik ose juridik, i cili zotëron, transferon, importon, eksporton, merr, përdor, fabrikon ose instalon pajisje me rrezatim jojonizues.

Neni 4

Detyrimet e subjekteve që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues

1. Të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimeve jojonizuese, janë subjekt i këtij ligji.

2. Çdo person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, është i detyruar të pajiset me akt miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jojonizuese.

3. Personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, të pajisur me akt miratimi, detyrohen të zbatojnë dispozitat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet e tjera në zbatim të tij.

4. Personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që kryejnë veprimtari me burime të rrezatimeve jojonizuese, duhet të punësojnë persona të kualifikuar për punë me këto pajisje, të monitorojnë ekspozimet e tyre dhe të marrin masat e nevojshme për uljen e ekspozimit, kur ato janë mbi nivelet kufi.

5. Punonjësit, që nuk kanë kualifikimin e nevojshëm për punë me pajisjet që emetojnë rrezatim jojonizues, duhet të trajtohen si individë të publikut.

6. Instituti i Shëndetit Publik bën vlerësimin e shëndetit, të efekteve të rrezatimit jojonizues si për punonjësit e ekspozuar profesionalisht, edhe për publikun.

KREU II

ORGANIZIMI I STRUKTURAVE TË MBROJTJES NGA RREZATIMET JOJONIZUESE

Neni 5

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

1. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet është autoriteti përgjegjës kombëtar rregullator, që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet përcakton masat e nevojshme për të siguruar, në çdo rast, që ekspozimet e çdo instalimi ose pajisjeje, që emetojnë rrezatim jojonizues, të jenë në përputhje me normat e miratuara nga rregulloret përkatëse.

2. Përbërja, organizimi, funksionimi dhe mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Detyrat e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, përveç detyrave të përcaktuara në fushën e rrezatimit jonizues, ka edhe këto detyra për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese:

- a) harton rregulloret dhe miraton udhëzimet e aktet e praktikave të mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë personat fizikë ose juridikë;
- b) kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen nga rrezatimi jojonizues;
- c) miraton veprimtaritë me burime të rrezatimit jojonizues;
- ç) bën rekomandime dhe propozime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- d) bashkëpunon me organizmat kombëtare e ndërkombëtare për problemet e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- dh) angazhon institucionet kërkimore-shkencore në të gjithë vendin për zgjidhjen e problemeve kombëtare në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- e) përcakton kërkesat për mbikëqyrjen e veprimtarive me rrezatim jojonizues dhe monitoron ekspozimet e publikut dhe ekspozimet profesionale;
- ë) kërkon nga çdo operator, prodhues, importues ose instalues i pajisjeve, që emetojnë rrezatim jojonizues, të përmbushë respektimin e kufijve bazë dhe të kufijve të ekspozimit, nëpërmjet matjeve, deklaratave me shkrim ose certifikatave që lëshohen nga prodhuesit;
- f) miraton procedurat testuese për pajisjet, që emetojnë rrezatim jojonizues dhe ato elektromjekësore, si dhe për kompanitë që do të bëjnë testimin e tyre.

Neni 7

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet është njësi ekzekutive e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet, e cila, përveç detyrave të përcaktuara në fushën e rrezatimit jonizues, kryen edhe këto detyra:

- a) paraqet për miratim në komision aktet rregulluese të veprimtarisë së mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- b) kontrollon në praktikë dhe mbikëqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- c) kryen inspektimin e instalimeve me rrezatim jojonizues;
- ç) mbledh informacion dhe kryen matjet bazë e analizat e nevojshme për kontrollin e mbrojtjes nga rrezatimet jojonizuese;
- d) përgatit dosjet për miratimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues;
- dh) përgatit materialet e mbledhjeve të komisionit, si dhe raportet e kërkuara prej tij;
- e) mban inventarin kombëtar të instalimeve dhe regjistrat e posaçëm për të gjitha matjet e kryera.

Neni 8

Informimi

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet ose personat fizikë apo juridikë, të miratuar, që kanë marrëveshje me të, mund të publikojnë ose të shpërndajnë informacione, të dhëna për matje apo çdo material që ka lidhje me dispozitat e këtij ligji, në faqen zyrtare ose nëpërmjet broshurave të ndryshme.



KREU III SANKSIONET

Neni 9 **Sanksionet**

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) shkelja e pikës 2 të nenit 4, për mospajisje me akt miratimi nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, dënohet me gjobë 500 000 lekë;

b) shkelja e pikës 5 të nenit 4, për punësimin e punonjësve të pakualifikuar, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

c) shkelja e pikës 3 të nenit 4, për moszbatimin e kërkesave të ligjit dhe akteve, të dala në zbatim të tij, dënohet me gjobë nga 10 000 deri në 300 000 lekë.

2. Gjjobat vendosen nga inspektorët e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet.

3. Kundër vendimit të inspektorëve bëhet ankim në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet brenda 10 ditëve.

4. Vendimi i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet ankimohet në gjykatë brenda 30 ditëve.

5. Procedurat për vënien e gjobës dhe ankimimin rregullohen me ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10 **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Rregulloret për sigurinë e publikut dhe të punonjësve të ekspozuar ndaj rrezatimeve jojonizuese miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7141, datë 28.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 470, datë 13.10.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 171, DATË 22.10.2009 “PËR
PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Autoriteti kompetent, në bashkëpunim me UP-në, kur ka një të tillë, bën regjistrimin e kandidatëve për kryerjen e praktikës profesionale dhe siguron që praktika të kryhet nën drejtimin e një profesionisti, i cili e ushtron profesionin prej jo më pak se tre vjetësh dhe jep garanci të mjaftueshme për përgatitjen teoriko-praktike të praktikantit.

Në përfundim të praktikës profesionale, kandidati i nënshtrohet “Vlerësimit për aftësimin praktik”, të organizuar dhe të zhvilluar nga autoriteti kompetent, nëpërmjet strukturave të veta. Praktika profesionale konsiderohet e kryer vetëm pas vlerësimit pozitiv të aftësimit praktik.

Modalitetet e organizimit të vlerësimit të aftësimit praktik përcaktohen në rregulloren e praktikës profesionale, që miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

4. Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, praktikantit i paguhen sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore nga subjekti pranë të cilit ai kryen praktikën profesionale.”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 13, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) tarifat e provimit të shtetit.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7142, datë 28.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**



VENDIM
Nr.130, datë 13.10.2011

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA DHE EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 114 dhe 116 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Ibsen Elezi lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Zoti Alban Karapici zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.7100, datë 11.10.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mehmet Sali Ramadani
2. Fitim Niman Aliu
3. Isa Asan Bunjaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.680, datë 5.10.2011

**PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË
MENAXHIMIT PËR KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE TË
KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të pikës 2 të nenit 28 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shpërblimit të kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Menaxhimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik është, përkatësisht, 20 000 (njëzet mijë) lekë dhe 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 4 (katër) herë në vit.
 2. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 4 (katër) herë në vit.
 3. Pika 1 e vendimit nr.548, datë 1.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, shfuqizohet.
 4. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.682, datë 5.10.2011

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.472, DATË 2.7.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E FONDEVE BUXHETORE, PËR VITIN 2011”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “d” të pikës 1 të vendimit nr.472, datë 2.7.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:



“Përfundimisht, ky rregull nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës, që marrin pjesë në shërbime operacionale dhe kryerja e pushimeve vjetore të vitit 2010 gjatë pjesës së mbetur të vitit 2011, vlerësohet e pamundur nga titullari i institucionit.”

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.683, datë 5.10.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.47, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 4 të vendimit nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, punëdhënësi nuk duhet të bëjë pushime nga puna, pa shkaqe të arsyeshme, të punëmarrësve të tjerë të punësuar më parë.”

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.684, datë 5.10.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.627, DATË 31.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të

punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011-2012, të jenë 9430, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

- a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme 8650;
- b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë 40;
- c) Kuotat për transferim studimesh 200;
- ç) Kuotat për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj 400;
- d) Kuota për personat që nuk shikojnë 20;
- e) Kuota për romët/ballkano-egjiptianë 20;
- f) Kuota për të përndjekurit politikë 100.”.

2. Në fund të tabelës 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet programi i studimit sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

A	B	C	D	E
K_Universiteti	K_ID_Programit	K_Emërtimi_Programit	Kuota për studentë shqiptarë	Kuota nga trojet dhe për të huajt
Universiteti i Sporteve të Tiranës	86	Shkencat e lëvizjes	80	0



VENDIM
Nr.685, datë 5.10.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.391, DATË 1.6.2011 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË
“NXITJA E BIZNESIT SOCIAL”, SHA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.10 376, datë 10.2.2011 “Për krijimin e shoqërisë “Nxitja e biznesit social”, sh.a.”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në statutin e shoqërisë “Nxitja e biznesit social”, sh.a., që i bashkëlidhet vendimit nr.391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në nenin 5 “Kapitali”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 formulohet, si më poshtë vijon:

“2. Në çastin e themelimit, shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministri i Financave, kontribuon në para, në kapitalin e shoqërisë, me një shumë prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, e cila përbën kapitalin fillestar të shoqërisë. Kjo shumë do të përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për vitin 2011.”.

b) Në pikën 3, fjalët “...Ministria e Financave...” zëvendësohen me “...Ministri i Financave...”.

2. Pas pikës 2 të nenit 8, “Rritja e kapitalit”, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Kontributi i shtetit shqiptar për rritjen e kapitalit të shoqërisë do të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.687, datë 5.10.2011

**PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA, SI DHE
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË
KONFISKUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 pika 2 e 34 pika 2, të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI I AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara është institucion qendror, me qendër në Tiranë, në varësi të Ministrit të Financave.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara funksionon si autoritet përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë apo me vendime dhe urdhra administrative sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Financave.

4. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Agjencia drejtohet nga kryeadministratori, i cili emërohet nga Ministri i Financave.

6. Buxheti i Agjencisë përbëhet nga buxheti i shtetit, si pjesë përbërëse e buxhetit të Ministrisë së Financave, dhe nga të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara. Buxheti i shtetit mbulon shpenzimet për mbajtjen dhe funksionimin e Agjencisë, si dhe ato për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, kur të ardhurat e siguruarra nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive nuk janë të mjaftueshme.

7. Të ardhurat nga administrimi i pasurive përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet e administrimit të pasurive.

8. Të ardhurat e përfuara nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara shkojnë në:

a) Buxhetin e Shtetit;

b) Fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;

c) Llogarinë e Agjencisë për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Shpërndarja e këtij fondi përcaktohet me urdhër të Ministrit të Financave.

II. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoriteti përgjegjës” për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, në vijim Agjencia.

2. “Administrim i pasurisë”, të gjitha veprimet dhe procedurat ligjore që kryhen nga Agjencia apo nga administratori i pasurisë, me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen dhe, kur është e mundur, shtimin e vlerës së pasurisë, që nga çasti i marrjes dijeni për aktin e sekuestros/konfiskimit dhe deri në atë të tjetërsimit ose të revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë.

3. “Marrja në dorëzim e pasurisë”, veprimet dhe procedurat ligjore të kryera nga Agjencia dhe administratori i pasurisë, për kalimin faktik të pasurive në administrim të Agjencisë me anë të inventarizimit të dokumentuar të pasurisë.

4. “Menaxhim i drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve”, veprimet dhe procedurat që kryhen nga Agjencia dhe administratori i pasurisë, pas marrjes në dorëzim të pasurisë deri në çastin e tjetërsimit të saj.

5. “Tjetërsim”, kalimi i të drejtave reale të pasurisë nga pronari tek të tretët, nëpërmjet një prej formave të parashikuara nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

6. “Administrator koordinator”, punonjësi buxhetor i Agjencisë, i cili koordinon, udhëzon, mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e procedurave ligjore nga administratori i pasurisë, për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara, sipas fushës përkatëse që ai mbulon (juridike, financiare, terreni etj.).



7. “Administrator i pasurisë”, personi fizik a juridik, i specializuar në fushën e administrimit të pasurive, i cili është i autorizuar dhe/ose kontraktuar nga Agjencia për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara.

8. “Njësi pasurie”, një pasuri me numër të vetëm identifikimi, i cili identifikon pasurinë (e luajtshme/paluajtshme) në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive.

9. “Përdorim i pasurisë”, ushtrimi i së drejtës për shfrytëzimin e pasurisë.

10. “Të ardhurat nga administrimi i pasurive”, të gjitha të hyrat në vlera monetare që përfitohen nga administrimi i pasurive të sekuestruara/konfiskuara apo burime të tjera të ligjshme.

11. “Shpenzimet për administrimin e pasurive”, të gjitha të dalat në vlera monetare, që përdoren për administrimin e pasurive.

III. OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

Agjencia ka për objekt të veprimtarisë:

1. Administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

2. Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

3. Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykatë.

IV. KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË

Agjencia ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

1. Merr në dorëzim pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara, në zbatim të vendimeve të Gjykatës për Krimet e Rënda, vendimeve të Këshillit të Ministrave, urdhrave të Ministrit të Financave, vendimeve të gjykatave të tjera apo ligjeve të veçanta.

2. Ruan, mirëmban dhe administron pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara.

3. Rrit vlerën e pasurisë në administrim, nëse është e mundur, nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo të tretëve.

4. Përgatit:

a) Raporte për organin që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit për pasurinë e marrë në administrim.

b) Raporte për Komitetin Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar për pasuritë e konfiskuara, të paktën një herë në vit, 3-mujorin e parë.

c) Raporte tekniko-financiare për pasuritë e konfiskuara, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit të formës së prerë.

ç) Raportin vjetor, brenda muajit janar të vitit pasardhës, drejtuar Ministrit të Financave.

5. Paraqet kërkesat për regjistrimin në regjistrat publikë përkatës, në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të AAPSK-së, të pasurive të konfiskuara me vendim të formës së prerë.

6. Përgatit dosjen e plotë të dokumentacionit ligjor për tjetërsimin e pasurive të konfiskuara, dhënien në përgjegjësi administrimi apo huapërdorjeje.

7. Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për shitjen e pronave publike dhe për shitjen e pasurive të konfiskuara.

8. Mbikëqyr veprimtarinë e përfituesit, të cilit i është dhënë në përdorim një pasuri e konfiskuar, nëse përdorimi i pasurisë është në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave të nxjerrë për këtë qëllim.

9. Bën verifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për kërkesat për financimin e projekteve nga fondi i veçantë për parandalimin e kriminalitetit.

10. Ndërmerr nisma ligjore dhe ia propozon ato Ministrit të Financave.

V. KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYEADMINISTRATORIT, ADMINISTRATORIT KOORDINATOR DHE ADMINISTRATORIT TË PASURISË

1. Kryeadministratori ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

1.1. Organizon dhe drejton veprimtarinë e Agjencisë, përgjigjet dhe raporton përpara ministrit të Financave dhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për masat kundër krimit të organizuar, sipas dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 13.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

1.2. Mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

1.3. Përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

1.4. I paraqet Gjykatës për Krimet e Rënda, të paktën një herë në vit, brenda 3 - muorit të parë të vitit, listën e administratorëve të pasurisë, të cilët plotësojnë kriteret ligjore dhe janë të trajnuar nga Agjencia.

1.5. I paraqet Ministrit të Financave, për miratim, rregulloren e brendshme të punës së Agjencisë.

1.6. Emëron administratorët e pasurive, të caktuar nominalisht nga Gjykata për Krimet e Rënda, për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara, sipas dispozitave të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, si dhe administratorët për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara, që i caktohen për administrim Agjencisë sipas këtij vendimi.

1.7. Emëron ndihmësadministratorët, sipas propozimit të administratorëve të pasurisë.

1.8. Negocion dhe lidh kontratën me administratorin/ ndihmësadministratorin, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.7850, datë 29.9.1994 “Kodi Civil”, të ndryshuar. Kriteret dhe limitet e pagave të administratorëve dhe ndihmësadministratorëve të pasurive përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij vendimi.

1.9. Negocion dhe lidh kontratat e qirasë, huapërdorjes dhe enfiteozës për pasuritë e sekuestruara/konfiskuara.

1.10. Lidh kontratat si përfaqësues i autoritetit kontraktor në procedurat e prokurimit publik.

1.11. Ngre komisionet për:

- Vlerësimin e çmimit të tregut për dhënien me qira të pasurive të sekuestruara/konfiskuara;
- Vlerësimin e çmimit të shitjes së pasurive të konfiskuara;

- Vlerësimin e çmimit të shitjes për pasuritë e sekuestruara për të cilat gjykata ka vendosur shitjen e tyre.

1.12. Kryeadministratori i paraqet në mënyrë progresive si Gjykatës, ashtu edhe Prokurorisë për Krimet e Rënda, të gjitha shpenzimet proceduriale, që nga çasti i marrjes në dorëzim të pasurisë së administruar deri në fazën e konfiskimit të saj, sipas parashikimeve të nenit 25, të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

2. Administratori koordinator:

2.1. Administratori koordinator, sipas sektorit që mbulon, koordinon, kontrollon dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratorëve të pasurive dhe zbatimin e procedurave ligjore të administrimit të pasurive të sekuestruara/konfiskuara.

2.2. Kontrollon dhe miraton raportet e përgatitura nga administratorët e pasurive, përpara se të kalojnë për miratim te kryeadministratori.



2.3. Verifikon dhe dërgon për miratim, te kryeadministratori, kërkesat për shpenzimet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e pasurive, të propozuara nga administratori i pasurive.

2.4. Përgatit statistika, analiza dhe raporte periodike mujore, si dhe sa herë që i kërkohen nga kryeadministratori.

2.5. Në bazë të propozimeve të administratorit të pasurive, i rekomandon kryeadministratorit mënyrën e administrimit të pasurive nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve.

3. Administratori i pasurisë:

3.1 Administratori i pasurisë, i emëruar nga Gjykata, për pasuritë e sekuestruara, të regjistruara në regjistra publikë, duhet të bëjë menjëherë njoftimin e masës së sekuestrimit në zyrat ku mbahen këta regjistra.

3.2 Merr në administrim pasuritë e sekuestruara/konfiskuara që i caktohen për administrim.

3.3 Administron dhe, nëse është e mundur, rrit vlerën për pasuritë që ka në administrim nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo me anë të të tretëve.

3.4 Harton të gjitha shkresat zyrtare dhe mban korrespondencën me institucionet dhe subjektet me të cilat duhet të bashkëpunohet për marrjen në administrim, menaxhimin dhe tjetërsimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara.

3.5 Paraqet:

a) Raport të hollësishëm, brenda 15 ditëve nga emërimi i tij, për kryeadministratorin dhe autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit, për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes së pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, duke njoftuar njëkohësisht prokurorin e çështjes, kur pasuria është sekuestruar me kërkesë të kësaj të fundit;

b) Raport për marrjen në administrim të pasurisë, për të cilin njofton kryeadministratorin, vë në dijeni autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit dhe prokurorin e çështjes;

c) Raporte periodike për administrimin e pasurive të sekuestruara, sipas afateve të caktuara nga gjykata, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës;

ç) Kërkesën për informim pranë prokurorisë dhe gjykatës, 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të masës së sekuestrimit, me qëllim marrjen dijeni nga ana e prokurorit të kërkesës për konfiskim apo shtyrje të afatit të sekuestrimit;

d) Raportin tekniko-financiar, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e formës së prerë, për konfiskimin e pasurisë;

dh) Raportin për pasuritë e tjera, që mund të jenë objekt i masës së sekuestrimit, për ekzistencën e të cilave është vënë në dijeni gjatë administrimit, por nuk janë përcaktuar në masën e sekuestrimit/konfiskimit, dhe ia paraqet atë autoritetit përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit dhe kryeadministratorit.

3.6. Administratori nuk lejohet të marrë pjesë në gjykim, të marrë kredi, të nënshkruajë marrëveshje pajtimi, arbitrazhi, premtimi, dorëzanie, hipotekimi ose tjetërsimi të pasurive të sekuestruara/konfiskuara, apo të kryejë veprime të tjera juridike administrimi jo të zakonshëm.

VI. ADMINISTRIMI I PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

Administrimi i pasurive nga Agjencia kalon në tri faza:

- Marrjen në administrim;
- Menaxhimin;
- Tjetërsimin, dhënien në përgjegjësi administrimi dhe huapërdorje.

1. Marrja në administrim

a) Marrja në administrim fillon me marrjen dijeni për aktin e nxjerrë nga autoriteti që ka vendosur masën e sekuestrimit/konfiskimit ndaj pasurisë ose me marrjen dijeni, prej prokurorisë, të kërkesës për sekuestrim/konfiskim, që kjo e fundit i drejton gjykatës.

b) Marrja në administrim bëhet nga administratori i pasurisë në prani të administratorit që merret me koordinimin në terren ose, në mungesë të këtij të fundit, të një administratori/administratori të pasurisë, të caktuar nga kryeadministratori.

2	15590	26.11.2008	Viktor	Serimi	Zef	Age	06.12.1965	Shkoder	M	2 vjet,3 muaj, 17 ditë	1,680,000	0	280,000	1932000	11989	0		

UDHËZIM
Nr.37, datë 23.9.2011

**PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2011-2012 NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007
“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2011-2012 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë me kohë të plotë, të fillojë më 10 tetor 2011 dhe të përfundojë më 30 shtator 2012.

2. Viti akademik 2011-2012 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, të fillojë në datën 7 nëntor 2011 dhe të përfundojë në 30 shtator 2012.

3. Viti akademik 2011-2012 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave/Master i Arteve të Bukura”, të fillojë jo më vonë se 2 nëntor 2011 dhe të përfundojnë me realizimin e plotë të programit mësimor në varësi të krediteve të miratuara për programin e studimit.

4. Periudha 24 dhjetor 2011 deri më 3 janar 2012 të jetë periudhë pushimesh për studentët.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) brenda datës 24 dhjetor 2011 një listë të studentëve të regjistruar në vitin akademik 2011-2011, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD). AKP-ja brenda datës 25 janar 2012 u dërgon IAL-ve publike listën përkatëse me numrat e matikulimit të studentëve.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtorinë e konvikteve, listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

7. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi për vitin akademik 2011-2012.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



UDHËZIM
Nr.38, datë 23.9.2011

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK
2011-2012**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapitale shtetërore”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht. Kriteret duhet të jenë të afërta me ato që respektohen për pranimin në programet respektive me kohë të plotë. Nuk pranohen aplikime nga kandidatët të shpallur fitues me formularët A2 dhe A3, të regjistruar në listat përfundimtare.

Kuotat e miratuara me vendimin nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave do të përdoren:

a) në masën 80% për studentë që nuk janë regjistruar në asnjë program studimi ose nuk kanë përfunduar një të tillë në IAL-të publike, me kohë të plotë ose të pjesshme;

b) në masën 20% si program i dytë studimi për kandidatë që kanë përfunduar një program studimi universitar.

2. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimin dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë. Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

4. Aplikimi për regjistrin në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore dhe certifikatës së notave, ose të ndonjë dëftese/diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011, të dorëzojnë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

- c) 2 fotografi;
- d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1 500 lekë, paguar në Postën Shqiptare;
- e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në institucionet e arsimit të lartë publik.

5. Në qoftë se kandidati nuk ka diplomë të Maturës Shtetërore apo dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të saj të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

6. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretaritë mësimore, përveç dokumentacionit të pikës 4, edhe diplomën e lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë (ose fotokopje të saj të noterizuar), diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit (ose fotokopje të saj të noterizuar), të vlerësuar e barasvlershme me të në Shqipëri.

7. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, përveç dokumentacionit të pikave 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, duhet t'u nënshtrohen edhe kritereve të veçanta (konkurseve të pranimit), të vendosura nga ky institucion, për pranimet në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, të bëra publike paraprakisht.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 14.10.2011, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të aplikimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë.

9. Aplikimi i kandidatëve në programin e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, të zhvillohet nga data 17.10.2011 deri në datën 21.10.2011, prej orës 8:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00 të datës 27.10.2011, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës.

11. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë ku janë shpallur fitues, të zhvillohet nga data 1.11.2011 deri në datën 6.11.2011, prej orës 08:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Regjistrimi i kandidatëve fitues të bëhet vetëm me diplomën e Maturës Shtetërore dhe dëftesën e pjekurisë origjinale të shkollës së mesme, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij udhëzimi. Dokumentet e kandidatëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës.

13. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar, për të marrë numrin e matrikulimit. Kandidatët që rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi të ciklit të parë, ose të dytë, me kohë të plotë apo të pjesshme, në IAL-të publike, nuk marrin numër matrikulimi. AKP-ja pas verifikimit i kërkon IAL-ve t'i çregjistrojë ata.

14. Aplikimi dhe regjistrimi i kandidatëve për transferim studimesh kryhet pas shpërndarjes nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, të kuotave të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve në statutet dhe rregulloret e IAL-ve publike.

15. Regjistrimi i kandidatëve nga Republika e Kosovës, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, si dhe për shtetasit e huaj, sipas shkronjës "ç" të pikës 1 të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të



lartë të Republikës së Shqipërisë, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, kryhet pas dërgimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të urdhrin të shpërndarjes së kuotave të përcaktuara me vendimin nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave.

16. Kandidatët nga Republika e Kosovës dhe kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit aplikojnë pranë institucioneve publike të arsimit të lartë. Përzgjedhja e fituesve bëhet sipas pikës 1 të këtij udhëzimi brenda kuotave të parashikuara në urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për shpërndarjen e kuotave të pranimit për këta kandidatë. IAL-të të pranojnë kandidatë nga Republika e Kosovës dhe nga trojet jashtë kufijve të vendit edhe në ato raste kur nuk janë parashikuar kuota për to, pasi këta kandidatë do të konsiderohen në rishpërndarjen e kuotave.

17. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.6386/1, datë 7.10.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 6 germa “dh” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Se, me vendimin penal nr.437, datë 2.12.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit Ylli Mehmeti për kryerjen e veprës penale “Falsifikim të dokumentit bërë nga personi që e ka për detyrë lëshimin e tyre”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit të Procedurës Penale dhe dënimin e tij me 300 000 lekë gjobë. Bazuar në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, Ylli Mehmeti, me detyrë noter, përfundimisht është dënuar me 200 0000 lekë gjobë. Ky vendim merr formë të prerë me vendimin nr.67, datë 9.2.2011 të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka vendosur mospranim të ankimit. Prokurori ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit nr.437, datë 2.12.2009.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 6 germa “dh” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Ylli Mehmeti, anëtar i Dhomës së Noterisë Vlorë.

2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 5 anëtarë.

a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.

b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.

c) Znj.Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.

d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Vlorë.

e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Vlorë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Vlorë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z.Ylli Mehmeti nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t'u njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

VENDIM
Nr.87, datë 26.9.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EURON ENERGY GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedura e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Euron Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Orgjost i ri” me fuqi 4.8 MW, “Bele 1” me fuqi 5 MW, “Bele 2” me fuqi 11 MW, “Topojani 1” me fuqi 2.9 MW dhe “Topojani 2” me fuqi 5.8 MW, për një periudhë 30-vjeçare.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr.88, datë 26.9.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EURON ENERGY GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 2, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Euron Energy Group” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.89, datë 26.9.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“MALIDO ENERGJI” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR “HEC
KLOS” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “II”, 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s” të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21 datë 18.3.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme” të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Klos” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k. është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

- Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Klos” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr.90, datë 26.9.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “MALIDO ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8 dhe 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pikat 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.91, datë 26.9.2011**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERALD ENERGJITIK” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “SHEMRI” DHE “MGULLE”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, 13 pika 1 germa “a” dhe 15 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erald Energjitik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me lejet nga institucionet e tjera (pika e lidhjes nga rrjeti i shpërndarjes; neni 9 pika 4.1.5), rezulton në proces realizimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Erald Energjitik” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: “Shemri” me fuqi 1 MW dhe “Mgulle” me fuqi 0.28 MW, për një afat 30-vjeçar, me kusht që:

- Shoqëria “Erald Energjitik” të dorëzojë “Miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes”, brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licencës.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr.92, datë 26.9.2011

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË LICENCËS NR.63 TË DHËNË ME VENDIM TË BORDIT
TË KOMISIONERËVE NR.89, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 19, DATË 8.3.2010 PËR “ALBANIAN GREEN
ENERGY”**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.,

dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, TEC me biomasë të lëngshme, për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin final të ndërtimit të kësaj linje nga Ministria e Ambientit dhe Mbrojtjes së Territorit të Detit në Itali, duke qenë se ndërtimi i linjave të interkonjeksionit, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.89, datë 6.8.2008, për dhenien e licencës shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike (Bllok motorë - gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme Shëngjin, Lezhë) të bëhen këto ndryshime:

Pika 1 germa “d” të ndryshohet si më poshtë:

“d.1. Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë në përputhje të afatit të përcaktuar në lejen e METE-s nr.4/1, datë 7.12.2009, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2010, të ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.542, datë 27.7.2011 për ndërtimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar ndërmjet Kallmet/Lezhë dhe Zapponeta/Manfredonia.

d.2. Koha e zbatimit të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit të përcaktuar në pikën d.1.”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Albanian Green Energy” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.93, datë 26.9.2011

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË LICENCËS NR.64, E DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERËVE NR.90, DATË 6.8.2008 PËR “BIOPOWER GREEN ENERGY”**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.,

dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, me erë “BPGE 1” dhe “BPGE 2” për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin e linjës tregtare nga pala italiane, duke qenë se ndërtimi i linjave të interkonjeksionit, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj,

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.90, datë 6.8.2008 për dhënien e licencës shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet Eolik “BPGE 1” dhe “BPGE 2”, të bëhen këto ndryshime:

Pika 1 germa “e” të ndryshohet si më poshtë:

“e. 1. Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë në përputhje të afatit të përcaktuar në lejen e METE-s nr.4/1, datë 7.12.2009, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2010, të ndryshuar, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.542, datë 27.7.2011 për ndërtimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar ndërmjet Kallmet/Lezhë dhe Zapponeta/Manfredonia.

e.2. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit të përcaktuar në pikën e.1.”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Biopower Green Energy” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr.94, datë 26.9.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“KESH” SHA PËR TRANSFERIMIN E ASETVE, PÛRKATËSISHT “NËNSTACIONI
LANABREGAS”, “NËNSTACIONI BOGOVË”, “NËNSTACIONI GJANC”,
“NËNSTACIONI BUSHAT 110/20KV”, “RRJETI 20 KV KOPLIK”, “NËNSTACIONI
SHKODËR 110/20KV”, “NËNSTACIONI FIER 110/20KV”, “NËNSTACIONI
GJIROKASTËR”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika “1”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e Transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria KESH sh.a. tek shoqëria “CEZ shpërndarje” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 Emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte.)

- Neni 7, pika 1.3 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “KESH” sh.a. “Për transferimin e aseteve, përkatësisht të “Nënstacionit Lanabregas”; “Nënstacionit Bogovë”, “Nënstacionit Gjanc”, “Nënstacionit Bushat 110/20 kv”, “Rrjetit 20 kv Koplik”, “Nënstacionit Shkodër 110/20 kv”, “Nënstacionit Fier 110/20 kv”, “Nënstacionit Gjirokastrë”, tek “CEZ shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.38, datë 19.9.2011

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR PROGRAMIN E NXITJES
SË PUNËSIMIT TË FEMRAVE NGA GRUPET E VEÇANTA”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|---------|
| - z. Nasip Naço | Kryetar |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | Anëtare |
| - z. Besjan Pasha | Anëtar |
| - z. Zef Preçi | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 19.9.2011, shqyrtoi njoftimin e planit “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”. Njoftimi është bërë pranë Drejtorisë së Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) me shkresën nr.2262, datë 6.12.2010 dhe është regjistruar në regjistrin e DMTNSH-së me nr.AI/N/10/2011 datë 12.1.2011.

OBJEKTIVI/VAT: Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv të ndihmojë punëdhënësin të gjejnë kandidatin më të përshtatshëm duke siguruar një rekrutim të shpejtë nëpërmjet punësimit me kontratë me kohëzgjatje njëvjeçare të punëkërkuessë të papuna femra nga grupet e veçanta.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema ka për qëllim nxitjen dhe mbështetjen e krijimit të vendeve të reja të punës nëpërmjet subvencionimit të tyre nga buxheti i shtetit. Kostoja përballohet nga fondet vjetore të miratuara në ligjin për buxhetin e shtetit të vitit përkatës.

2. Kjo skemë ndihme i jep mundësi atyre ndërmarrjeve, projektet e të cilave janë fituese, të financohen nga buxheti i shtetit. Në këtë mënyrë gjatë zbatimit të projektit (skemës së ndihmës) ndërmarrja fituese është duke përballuar një pjesë (pika “a” dhe “c” e projektvendimit) ose të gjithë koston e punës (pika “b” e projektvendimit) nëpërmjet burimeve shtetërore. Duke u dhënë atyre përparësi apo efekt nxitës, të cilin në kushte të tjera nuk do të kishin përfituar.

3. Skema ka karakter përzgjedhës, sepse jo të gjitha ndërmarrjet janë të afta për të aplikuar dhe më pas për të plotësuar të gjitha kriteret e përfitimit nga kjo skemë.

4. Skema ka efekt në tregti, pasi ka ndikim në veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve në një treg të caktuar. Gjithashtu skema ka mundësi për të shtrembëruar konkurrencën.

5. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

6. Përfituesit nga skema janë të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që kanë si qëllim marrjen, në punësim me kontratë të rregullt, punëkërkuessë të papuna femra nga lista e zyrës së punësimit.

7. Skema është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Intensiteti i ndihmës së parashikuar në këtë skemë është brenda kufijve të përcaktuar në nenin 10, shkronja “a” të ligjit “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, i cili përcakton se “Intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75% të kostove të pagave për punonjësit me aftësi të kufizuara dhe 50% të kostove të pagave për punonjësit në vështirësi”.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10 shkronja “a”, nenit 17 shkronja “ç”, të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin “Për dhënien e ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta.””
2. Punësimi i femrave nga grupet e veçanta duhet të kryhet për plotësimin e vendeve të reja të punës ose vendeve të lira të punës, të cilat janë krijuar si rezultat i largimit vullnetar, daljes në pension apo largimit të ligjshëm dhe jo për shkak të krijimit të vendeve të punës si pasojë e riorganizimit (punonjësit e larguar si të tepërt).
3. Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda datës 31 mars të çdo viti, t’i paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.
4. Të japë çdo informacion që do të kërkohej për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.
5. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço

VENDIM

Nr.39, datë 19.9.2011

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR MASËN E FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË QË HYJNË PËR HERË TË PARË NË PUNË”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|---------|
| - z. Nasip Naço | Kryetar |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | Anëtare |
| - z. Besjan Pasha | Anëtar |
| - z. Zef Preçi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 19.9.2011, shqyrtoi njoftimin e planit “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”. Njoftimi është bërë pranë Drejtorisë së Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) me shkresën nr.2263 datë 6.12.2010 dhe është regjistruar në Regjistrin e DMTNSH-së me nr. AI/N/11/2011 datë 12.1.2011.

OBJEKTIVI/VAT: Plani për dhënien e ndihmës synon të ndihmojë punëdhënësit të cilët punësojnë për herë të parë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme pune.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema ka si qëllim nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme nëpërmjet subvencionimit të tyre nga buxheti i shtetit. Kostoja përballohet nga fondet vjetore të miratuara në ligjin për buxhetin e shtetit të vitit përkatës.

2. Kjo skemë ndihme i jep mundësi atyre ndërmarrjeve, projektet e të cilave janë fituese, të financohen nga buxheti i shtetit. Në këtë mënyrë gjatë zbatimit të projektit (skemës së ndihmës) ndërmarrja fituese është duke përballuar një pjesë (pika “a” dhe “c” e projektvendimit) ose të gjithë koston e punës (pika “b” e projektvendimit) nëpërmjet burimeve shtetërore. Duke u dhënë atyre përparësi apo efekt nxitës, të cilin në kushte të tjera nuk do të kishin përfituar.

3. Skema ka karakter përzgjedhës, sepse jo të gjitha ndërmarrjet janë të afta për të aplikuar dhe më pas plotësuar të gjitha kriteret e përfitimit nga kjo skemë.

4. Skema ka efekt në tregti, pasi ka ndikim në veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve në një treg të caktuar. Gjithashtu skema ka mundësi për të shtrembëruar konkurrencën.

5. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

6. Përfituesit nga skema janë të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që kanë si qëllim marrjen, në punësim me kontratë të rregullt, punëkërkues të papunë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme pune.

7. Skema është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Intensiteti i ndihmës së parashikuar në këtë skemë është brenda kufijve të përcaktuar në nenin 10, shkronja “a” të ligjit “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, i cili përcakton se “Intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75% të kostove të pagave për punonjësit me aftësi të kufizuara dhe 50% të kostove të pagave për punonjësit në vështirësi”.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10, shkronja a, nenit 17 shkronja ç të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë”.

2. Punësimi i punëkërkuesve të papunë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme pune duhet të kryhet për plotësimin e vendeve të reja të punës ose vendeve të lira të punës, të cilat janë krijuar si rezultat i largimit vullnetar, daljes në pension apo largimit të ligjshëm dhe jo për shkak të krijimit të vendeve të punës si pasojë e riorganizimit (punonjësit e larguar si të tepërt).

3. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës:

- raportin për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar;
- të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço



VENDIM
Nr.40, datë 19.9.2011

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR PËRCAKTIMIN E
PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË FORMIMIT
PROFESIONAL TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NGA PERSONA JURIDIKË/FIZIKË
PRIVATË DHE ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|---------|
| - z. Nasip Naço | Kryetar |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | Anëtare |
| - z. Besjan Pasha | Anëtar |
| - z. Zef Preçi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 19.9.2011, shqyrtoi njoftimin e planit “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit për ofrimin e shërbimit të formimit profesional të punëkërkuesve të papunë nga persona juridikë/fizikë privatë dhe organizata jofitimprurëse”. Njoftimi është bërë pranë Drejtorisë së Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) me shkresën nr.2264, datë 6.12.2010 dhe është regjistruar në regjistrin e DMTNSH-së me nr.AL/N/12/2011 datë 12.1.2011.

OBJEKTIVI/VAT: Plani për dhënien e ndihmës synon të ndihmojë institucionet e formimit profesional private apo OJF të licencuara nga Qendra Kombëtare e Licencimeve, që organizojnë trajnim të përgjithshëm, për qëllim formimi institucional të personave punëkërkues të papunë, pra zhvillimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e nivelit profesional të fuqisë punëtore.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema ka për qëllim formimin profesional të punëkërkuesve të papunë, nëpërmjet subvencionimit të tyre nga buxheti i shtetit.

2. Kjo skemë ndihme i jep mundësi atyre ndërmarrjeve, projektet e të cilave janë fituese, të financohen nga buxheti i shtetit. Në këtë mënyrë gjatë zbatimit të projektit (skemës së ndihmës) ndërmarrja fituese është duke përballuar një pjesë të kostos së trajnimit (pika 1 e projektvendimit) nëpërmjet burimeve shtetërore. Duke u dhënë atyre përparësi apo efekt nxitës, të cilin në kushte të tjera nuk do të kishin përfituar.

3. Skema ka karakter përzgjedhës, sepse jo të gjitha ndërmarrjet janë të afta për të aplikuar dhe më pas plotësuar të gjitha kriteret e përfitimit nga kjo skemë.

4. Në lidhje me efektin në tregti, skema ka ndikim në veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve në një treg të caktuar, sepse ka edhe ndërmarrje të tjera që veprojnë në këtë treg.

5. Përfituesit nga skema janë të gjithë persona juridikë/fizikë privatë apo organizata jofitimprurëse të licencuara nga Qendra Kombëtare e Licencimeve, që organizojnë trajnim të përgjithshëm, për qëllim formimi institucional të personave punëkërkues të papunë.

6. Si bazë për dhënien e kësaj ndihme është projektvendimi “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit për ofrimin e shërbimit të formimit profesional të punëkërkuesve të papunë nga persona juridikë/fizikë privatë dhe organizata jofitimprurëse”.

7. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

8. Skema është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Kohëzgjatja e ndihmës parashikohet të jetë 5 vjet.

10. Kemi të bëjmë me ndihmë shtetërore në formën e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik.

11. Masa e ndihmës konsiderohet si ndihmë shtetërore për kompensimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik. Në bazë të udhëzimit “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik”, miratuar me vendimin e KNSH-së nr.26, datë 17.6.2008 klasifikohet shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik, çdo veprimtari ekonomike e konsideruar nga organet shtetërore me interes të veçantë publik dhe që nuk mund të sigurohet pa ndërhyrjen e shtetit. Shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik janë ato shërbime që kanë rëndësi të caktuar ekonomike, sociale dhe rajonale për publikun.

12. Në rastin e projektvendimit të propozuar ndërmarrjet të cilat janë fituese të procedurës së konkurrimit janë të destinuara që të ofrojnë një shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik, atë të formimit profesional të kursantëve punëkërkuar të papunë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 17 shkronja “ç” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin për “Për dhënien e ndihmës shtetërore “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit për ofrimin e shërbimit të formimit profesional të punëkërkuarve të papunë nga persona juridikë/fizikë privatë dhe organizata jofitimprurëse.””

2. Vlera e ndihmës duhet të përdoret vetëm për kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik. Në rast se ndihma e dhënë përdoret për ushtrimin e veprimtarive të tjera nga ana e përfituesve, do të konsiderohet ndihmë shtetërore e paligjshme.

3. Të njoftohet pranë Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës çdo ndryshim i mundshëm i planit të ndihmës sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore në fuqi.

4. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës:

- një përmbledhje të dokumentacionit të përfituesit të ndihmës, që duhet të përmbajë një detajim të kostos së trajnimit, buxhetit, pjesëmarrësve dhe një pasqyrë me dy alternativa të kostos totale (koston e trajnimit me ndihmë dhe kosto e trajnimit pa ndihmë);

- raportin për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar;

- të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

5. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço



VENDIM
Nr.41, datë 28.9.2011

**PËR SHQYRTIMIN E URDHRIT NR. 120 DATË 23.8.2010 TË MINISTRIT TË PUNËVE
PUBLIKE DHE TRANSPORTIT “PËR DHËNIEN E LEJES PËR PËRDORIMIN E
PASURISË SË PALUAJTSHME PUBLIKE AKSIT RRUGOR KOMBËTAR ME
KUNDËRSHPËRBLIM”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore i përbërë nga: z.Nasip Naço kryetar, z.Zef Preçi nënkryetar dhe znj.Mimoza Dhëmbi, z.Besjan Pesha, z.Arben Ndoci, anëtar, mori në shqyrtim urdhrin nr.120, datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) “Për dhënie e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundërshtëpërblim”.

OBJEKTI: Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore në urdhrin nr.120, datë 23.8.2010, i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për dhënie e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundërshtëpërblim”.

BAZA LIGJORE: ligji nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e Rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit.””

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE,

pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe gjithë dokumentacionin mbështetës:

Vëren se:

Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me shkresën nr.548/4 datë 20.7.2011 është informuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lidhur me problematikën e urdhrin nr.120 datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit kërkon në këtë shkresë “vlerësimin e të drejtës ekskluzive të përdorimit të pronës publike, si dhe vlerësimin e këtij urdhri nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore”.

Në bazë të neneve 20 dhe 25 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe neneve 4 dhe 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit.””

Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore (DMTNSH) ka kërkuar dhe administruar dokumentacionin e mëposhtëm:

- Me shkresën nr.6288, datë 2.9.2011, iu kërkuar MPPT-së plotësimi i formularit bazë për njoftim dhe një informacion i detajuar në lidhje me metodologjinë e përdorur për përcaktimin e tarifës së vendosur ndaj shoqërisë ATU, si detyrim për t’u paguar në Buxhetin e Shtetit.

- MPPT me shkresë nr.3777/1, datë 8.9.2011, dërgoi një informacion lidhur me procedurat e urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr.120 datë 23.8.2010, një shpjegim për arsyet e dhënies së kësaj leje, për përfitimet në buxhetin e shtetit, si dhe për të drejtën e ekskluzivitetit.

- MPPT me shkresë nr.6288/2, datë 16.9.2011 iu kërkuar edhe një herë plotësimi i formularit bazë për njoftimin e ndihmës shtetërore.

- Me shkresë nr.5408/3, datë 16.9.2011 iu kërkuar Autoritetit të Konkurrencës një informacion i detajuar në lidhje me efektin në konkurrencë të këtij akti administrativ.

- Autoritetit të Konkurrencës, me shkresë nr.414, datë 19.9.2011, dërgoi bashkëlidhur opinionin e Komisionit të Konkurrencës të kërkuar edhe nga Avokati i Shtetit.

- Me shkresë nr.5408, datë 16.9.2011 iu kërkuan Ministrisë së Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (MITIK), një informacion të detajuar në lidhje me operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e broadband-it (rrjet me bazë të gjerë) në Republikën e Shqipërisë, si dhe një kopje të padisë së ngritur në gjykatë nga shoqëria Albanian Telecommunication Union sh.p.k. (ATU) kundër kësaj ministrie.

- MITIK me shkresë nr.2735 datë 16.9.2011, dërgoi një informacion mbi tregun e ISP-ve dhe ofrimin e shërbimeve me brez të gjerë në Shqipëri, si dhe kopjen e kërkesëpadisë së ngritur nga subjekti shoqëria “Albanian Telecommunications Union” ndaj Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit.

- MPPT, me shkresë nr.3777/5, datë 23.9.2011, dërgoi formularin bazë për njoftim dhe informacione shtesë.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH), me shkresën nr.5408/7, datë 28.9.2011 i kërkoi Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postës (AKEP) një informacion të detajuar në lidhje me përkufizimin e rrjetit të fibrave optikë dhe atë me brez të gjerë (broadband), si dhe llojet e shërbimeve që përfshihen në këto rrjete; madhësinë e tregut të “broadband” (rrjet me brez të gjerë), si dhe dokumentet mbi bazën e të cilave është liberalizuar ky treg; kuadrin ligjor, si dhe organet kompetente që japin të drejta ekskluzive në këtë sektor.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi materialet e mësipërme, si dhe urdhrin nr.120, datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundërshtëpërbllim”,

konstatoi se:

- Shoqërisë ATU, me urdhër nr.120, datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, i është dhënë leja për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike të aksit rrugor kombëtar (sipas ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar), për vendosjen e rrjetit privat të fibrave optike me kundërshtëpërbllim dhe me destinacion përdorimi ekskluziv, mënyrë menaxhimi dhe mirëmbajtjeje (sipas pikës 1 të urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit);

- Objekti i lejes është dhënia e së drejtës së përdorimit (nëntokës) të aksit rrugor kombëtar, kundrejt kundërshtëpërbllimit nga përfaqësuesi i entit publik përgjegjës, subjektit privat ATU, që të ngrejë me fondet e tij rrjet fibrash optike, me qëllim që të zhvillojë për vete dhe të tretët, që në të ardhmen shprehin gatishmërinë të marrin pjesë në investim dhe të paguajnë tarifë vjetore, infrastrukturën e nevojshme ndihmëse, në përputhje me kushtet e lejes, për shërbime të teknologjisë së informacionit në rrjetin e fibrave optike (sipas nenit 1 të shtojcës 1 të urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit);

- Shoqërisë ATU i jepet e drejta e përdorimit të pasurisë publike me një kundërshtëpërbllim ndaj Buxhetit të Shtetit në masë 4% të të ardhurave në vit të krijuara nga shoqëria për shërbimet e ofruara. Kjo tarifë është përcaktuar duke marrë si mesatare pagesën “fee” koncesionare, për koncesione të suksesshme në Republikën e Shqipërisë në këto vite (sipas nenit 2 të shtojcës 1 të urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit);

- Shoqëria ATU është lejuar të ngrejë rrjetin e fibrave nën tokë në aksin rrugor të përcaktuar, me një investim prej 40 000 000 euro, pa TVSH (sipas nenit 3 të shtojcës 1 të urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit);

- Shoqëria ATU është lejuar të ngrejë rrjetin e fibrave optikë me investimet e saj me një kapacitet prej 2 vende të lira për vete dhe 4 vende për përdorues të tjerë. Përdoruesit e 4 vendeve të lira kanë detyrimin ligjor të paguajnë në favor të shtetit shqiptar një pagesë përdorimi për post prej 6% të të ardhurave të krijuara në vit (sipas neneve 3 dhe 7 të shtojcës 1 të urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit);

- Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, me nr.120, datë 23.8.2010, ka një afat të përcaktuar kohor për 20 vjet, me të drejtë ripërtëritje edhe 20 vjet të tjera, e arsyetuar me



volumin e madh të investimit që përfituesi do të kryejë (sipas nenit 16 të shtojcës 1 të urdhrit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit);

- Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, me nr.120, datë 23.8.2010, mbulon sektorin e transportit (rrugor) dhe sektorin e komunikimeve elektronike, rrjetin e fibrave optikë (broadband);

- Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, me nr.120, datë 23.8.2010, përcakton si përfitues të lejes shoqërinë Albanian Telecommunication Union sh.p.k. (ATU), subjekt juridik i regjistruar në QKR, datë 24.2.2010 i pajisur me NUIS L01425001U.

SHQYRTIMI I EKZISTENCËS SË NDIHMËS SHTETËRORE

Në bazë të nenit 4 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i cili parashikon:

1. “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

2. Format e ndihmës shtetërore përfshijnë kryesisht:

- a) grantet dhe subvencionet;
- b) përjashtimin, uljen dhe diferencimin e taksave;
- c) faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave;
- d) faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve;
- e) garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulta;
- f) uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;
- g) uljen e çmimit të produkteve të ofruara, ose shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut, ose blerjen e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut;

h) zmadhimin e kapitalit shtetëror tek ndërmarrjet ose ndryshim të vlerës së tij në rrethana të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat që vepron në kushte ekonomike normale.

3. Çdo ndihmë e ndaluar është e rimbursueshme.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerësoi kriteret e ndihmës shtetërore si më poshtë vijon:

KNSH-ja ka administruar dhe analizuar mundësinë/shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe ka rezultuar se në tregun e fibrave optike janë lejuar dy operatorë aktivë, një potencial në proces tenderimi pa përmendur dhe 136 ofrues shërbimi të aksesit në internet (ISP). Kjo provohet respektivisht me:

- Urdhrin nr.120, datë 23.8.2010, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundërshtpërblim”;

- Urdhri nr.185, datë 21.12.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike, aksit rrugor kombëtar” shoqërisë “Albtelekom sh.a.”;

- Urdhri i Ministrit të MITIK-ut “Për fillimin e procedurave për dhënie koncesioni “Për të vendosur, instaluar, zhvilluar dhe menaxhuar infrastrukturën e rrjetit kombëtar me brez të gjerë në Republikën e Shqipërisë, si dhe ftesa për pjesëmarrjen në procedurën konkurruese për dhënie koncesioni të (REKAB) publikuar në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik të datës 23 maj 2011.

- MPPT-ja me shkresë nr.3777/1 datë 8.9.2011, shprehet se shoqëria “Albanian Telecommunication Union” sh.p.k. (ATU), nuk është i vetmi operator ekskluziv në fushën e fibrave optikë. Në këtë fushë operon edhe shoqëria “Albtelecom” sh.a. me leje administrative nr.185, datë 21.12.2010, si dhe vendimin nr.3, datë 23.3.2011 i Këshillit Mbikëqyrës së Hekurudhës Shqiptare sh.a. MPPT-ja shprehet se shoqëria “Albanian Telecommunication Union” sh.p.k., është lejuar të

ngrejë rrjetin e fibrave optike me investimet e tij me një kapacitet prej 2 vende të lira për vete dhe 4 vende për përdorues të tjerë, ku secila nga linjat mund të shtohet me 6 linja secila, gjithsej 36.

- Ministria e Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit me shkresë nr. 2735, datë 16.9.2011 informon se, deri në datën 2 shtator 2011, në regjistrin e sipërmarrësve të autorizuar nga AKEP-ja për ofrimin e shërbimit të aksesit në internet, figurojnë të regjistruar gjithsej 136 ofrues shërbimi të aksesit në internet (ISP).

Komisioni i Ndhmës Shtetërore pasi shqyrtoi të drejtën e përdorimit të dhënë (të konsideruar si burim shtetëror) me anë të urdhrin nr.120 datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, arriti në konkluzionin se ajo nuk përputhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me asnjë nga format e parashikuara në nenin 4 pika 2 të ligjit, të vlerësuara si më poshtë:

- nuk është grant, sepse grant është një kontribut që një njësi qeveritare ia bën një njësie tjetër, po qeveritare. Përgjithësisht jepet për të mbështetur një program qeveritar (si p.sh. në fushat e arsimit, kulturës, shëndetësisë...etj.). Dhënie fondesh nga një ent shtetëror për të mbështetur një organizatë/institucion.

- nuk është subvencion, sepse subvencion është një shumë të hollash që një ent shtetëror ofron për të financuar një veprimtari ekonomike e cila ekonomikisht rezulton me humbje ose pa fitim, por që nga ana politike/shoqërore vlerësohet si e domosdoshme.

- nuk është përjashtim, ulje dhe diferencim i taksave, sepse përjashtim nga taksat janë masat që ndërmerr qeveria e një vendi në përjashtimin, uljen apo shtyrjen e një apo disa lloje taksash kundrejt një objekti të caktuar makroekonomik. Ulja e taksave i referohet një politike fiskale që përgjithësisht shpie në rritje të deficitit buxhetor kur nuk shoqërohet me ulje të shpenzimeve, ndërsa shtyrjet e taksave janë, detyrime që, në pajtim me palën përfituese të detyrimit apo mjedisin ligjor përkatës, paguhen në një afat të shtyrë apo të ardhshëm.

- nuk është falje e pagesave të prapambetura/gjobave dhe borxheve ose mbulim i humbjeve sepse në terminologjinë e kontabilitetit, i referohet njohjes së vlerës së reduktuar ose zero të një detyrimi.

- nuk është garanci mbi kreditë ose dhënie e kredive me norma interesi të ulta, sepse në sektorin financiar, një garanci e kredisë është një premtim nga ana e njëres palë (garantit/shtetit) për të marrë detyrimin e pagesës së borxhit të një huamarrësi në qoftë se huamarrësi nuk ka aftësi paguese të këtij detyrimi.

- nuk është ulje e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, sepse ulja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore është ulja e shumës së kontributeve të sigurimit shoqëror të deklaruar nga subjekti si detyrim për t'u paguar.

- nuk është ulje e çmimit të produkteve të ofruara, ose shitje e pronës shtetërore nën çmimin e tregut, ose blerje e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut sepse nuk ka të bëjë me shitblerjen e aseteve/produkteve të prekshme apo të paprekshme.

- nuk është zmadhim i kapitalit shtetëror tek ndërmarrjet ose ndryshim të vlerës së tij në rrethana, të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat që vepron në kushte ekonomike normale sepse nuk kemi të bëjmë me nënshkrim të aksioneve të reja nga ana e shtetit.

KNSH-ja pasi ka administruar dhe shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur, vëren se subjekti Shoqëria ATU është lejuar të operojë në sektorin e fibrave optike.

KNSH-ja konstaton se sektori i komunikimeve elektronike është një sektor i rregulluar me ligj të posaçëm, që garanton parimisht konkurrencën e operatorëve ekonomikë. Ky sektor rregullohet nga një institucion publik i pavarur i njohur si AKEP-i¹. Ndër objektivat rregullatorë të

¹ Neni 6, pika 1, i ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike", Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, "Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave".



AKEP-it është edhe nxitja e konkurrencës² dhe sigurimi i konkurrencës së lirë në këtë sektor³. Ligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” përcakton edhe përfshirjen e agjencive rregullatore në procesin e rregullimit të çështjeve të konkurrencës⁴, si dhe rolin e AKEP-it në procesin e dhënies së autorizimeve⁵ dhe detyrimin e tij për rregullimin e përgjithshëm të konkurrencës në këtë sektor⁶.

KNSH-ja gjatë shqyrtimit të materialeve konstaton se për sektorin e komunikimeve elektronike është e nevojshme kryerja e një analize të specializuar nga ana e AKEP-it dhe Autoritetit të Konkurrencës, detyrim i përcaktuar në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe akte të tjera ligjore që rregullojnë këtë sektor.

KNSH-ja shqyrtoi dhe analizoi pikën 3 të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, i cili parashikon që: “Çdo ndihmë e ndaluar është e rimbursueshme”, dhe sipas nenit 27 dhe 28 të ligjit të mësipërm, çdo ndihmë e cilësuar si e tillë duhej të kthehet.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm KNSH-ja vlerësoi se: rimbursimi/kthimi i ndihmës sipas parashikimeve të sipër cituara është i pazbatueshëm për çështjen në shqyrtim, pasi subjekti ATU nuk është përfitues i ndihmës shtetërore sipas përcaktimeve të këtij ligji.

KNSH-ja administroi dhe shqyrtoi përmbajtjen e kërkesëpadisë së ngritur nga subjekti shoqëria “Albanian Telecommunications Union” ndaj Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, me objekt:

- Shfuqizimin e aktit administrativ: i) urdhri i Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për fillimin e procedurave për dhënie koncesioni “Për të vendosur, instaluar, zhvilluar dhe menaxhuar infrastrukturën e rrjetit kombëtar me brez të gjerë (REKAB) në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ii) ftesa për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënie koncesioni të REKAB, të publikuar në Buletinin e datës 23 maj 2011, faqe 283, të Agjencisë së Prokurimit Publik;

- Anulimin e procedurës konkurruese të hapur nga MITIK për dhënie koncesioni “Për të vendosur, instaluar, zhvilluar dhe menaxhuar infrastrukturën e rrjetit kombëtar me brez të gjerë në Republikën e Shqipërisë” të caktuar për t’u zhvilluar në datë 14 korrik 2011 ora 12.00, të publikuar në Buletinin e datës 23 maj 2011, faqe 283 të Agjencisë së Prokurimit Publik”;

- Marrjen e masës për sigurimin e padisë duke pezulluar zbatimin aktit administrativ: i) urdhri i Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (MITIK) për fillimin e procedurave për dhënie koncesioni “Për të vendosur, instaluar, zhvilluar dhe menaxhuar infrastrukturën e rrjetit kombëtar me brez të gjerë (REKAB) në Republikën e Shqipërisë”, ii) ftesa për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënie koncesioni të REKAB, të publikuar në Buletinin e datës 23 maj 2011, faqe 283, të Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe iii) pezullimin e

² Neni 7, pika 3, i ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike”, Objektivat rregullatorë, “AKEP-i nxit konkurrencën efçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera”.

³ Neni 7, pika 3, shkronja ç, i ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike”, objektivat rregullatorë “Për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike”.

⁴ Neni 12, pika 2, i ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike”, bashkëpunimi, “AKEP-i dhe Autoriteti i Konkurrencës bashkëpunojnë për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën e sektorit të komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar”.

⁵ Neni 13, pika 1 i ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike”, autorizimi, “Cilido sipërmarrës është i lirë të ofrojë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji”.

⁶ Neni 31, pika 4, i ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike”, Rregullimi i Konkurrencës, “Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të BE-së”.

procedurës konkurruese të hapur nga MITIK, për dhënie koncesioni “Për të vendosur, instaluar, zhvilluar dhe menaxhuar infrastrukturën e rrjetit kombëtar me brez të gjerë në Republikën e Shqipërisë” të publikuar në Buletinin e datës 23 maj 2011, faqe 283 të Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe çdo akt administrativ të MITIK në lidhje me procedurën konkurruese, sipas të cilës shoqëria Albanian Telecommunications Union sh.p.k., ka përfituar të drejtën, për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike të aksit rrugor kombëtar me destinacion përdorimi ekskluziv, aksit kombëtar të rrugëve (sipas nenit 5 të shtojcës 1 të urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit).

Për sa i takon “eksluzivitetin”, Komisioni i Ndhmës Shtetërore konstaton se në këtë rast ekskluziviteti ka të bëjë me kryerjen e një shërbimi dhe përfitimi në një territor ekskluziv (aksit kombëtar të rrugëve).

Në këto rrethana, KNSH-ja arrin në përfundimin se nuk është në kompetencën e këtij komisioni vlerësimi dhe gjykimi i dhënies së të drejtës ekskluzive, si element për të përcaktuar nëse urdhri nr.120, datë 23.8.2010 i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundër shpërblim”, shtrembëron apo kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, si një kriter determinant për të konsideruar nëse kemi të bëjmë me ndihmë shtetërore apo jo.

Në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, në nenin 6/1 përcaktohet se:

“Marrëveshjet vertikale mund të përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të këtij ligji, për shkak të efikasitetit ekonomike, veçanërisht kur kanë si objekt ose si pasojë: a) kufizimin e shitjeve me kontakte të drejtpërdrejta brenda një territori ekskluziv ose ndaj një grupi klientësh ekskluzivë, të rezervuar për vetë furnizuesin ose për një shpërndarës tjetër të autorizuar nga furnizuesi, nëse një marrëveshje e tillë nuk kufizon shitjet e klientëve të shpërndarësit”.

Bazuar në këtë përcaktim, Komisioni i Ndhmës Shtetërore, vlerëson se autoriteti përgjegjës për të vlerësuar dhënien e të drejtës ekskluzive të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, nr.120, datë 23.8.2010 “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundër shpërblim”, është Autoriteti i Konkurrencës.

KNSH-ja ka administruar dhe analizuar shkresën nr.414 datë 19.9.2011 të Autoritetit të Konkurrencës, ku midis të tjerave citohet:

“Ministria e Punëve Publike dhe Transportit nuk ka respektuar detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 69, germa “b” të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, për të kryer vlerësimin e kufizimeve të mundshme të konkurrencës me dhënien e kësaj të drejte ekskluzive.

Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të nenit 2 pika 1 germa “ç”, vlerëson shkallën e kufizimit të konkurrencës, për ato ndërmarrje të cilat kanë përfituar të drejta ekskluzive duke marrë në konsideratë, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm apo ato, të cilat kanë karakterin e monopoleve të orientuara drejt sigurimit të të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që në ligj dhe në fakt nuk pengohet veprimtaria e tyre.

Analiza për kufizimet e konkurrencës, nga dhënia e të drejtave ekskluzive, në rastin në fjalë, mund të lidhet me kufizimin e mundshëm të zhvillimit teknologjik në tregun përkatës e cila kërkon paraprakisht vlerësimin e organeve të specializuara në fushën e komunikimeve elektronike.”

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson se:

- nuk ekzistojnë indiciet për të vlerësuar/matur, shtrembëron apo kërcënon të shtrembërojë konkurrencën e parashikuar në nenin 4 pika 1 të ligjit për ndihmën shtetërore;

- dhënia e të drejtës së përdorimit nuk mund të përcaktohet në asnjë nga format e ofrimit të ndihmës të parashikuara në nenin 4 pika 2, të ligjit për ndihmën shtetërore;



- dhënia e të drejtës me përdorim ekskluziv të pasurisë së paluajtshme publike, të aksit rrugor kombëtar, në bazë të nenit 44 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku citohet:

“1. Në rast urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, Komisioni, me nismën e tij, ose në bazë të një kërkesë nga palët e interesuara dhe në çdo kohë të procedurës, mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme, të përcaktuara në nenin 61 shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij ligji. 2. Vendimi, në mbështetje të pikës 1 të këtij neni, merret për një kohë të caktuar dhe mund të shtyhet në rast nevojë.”, shqyrtohet nga Autoriteti i Konkurrencës dhe AKEP-i.

Për arsyt e mësipërme, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se urdhri nr.120, datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundërshpërblim”, nuk plotëson njëkohësisht kriteret e përcaktuara në nenit 4 të ligjit të Ndihmës Shtetërore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, shkronja “ç”, 25, 27, 28, 29, 30 dhe 31 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Urdhri nr.120 datë 23.8.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike aksit rrugor kombëtar me kundërshpërblim”, nuk përbën ndihmë shtetërore, sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

2. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr.9121 datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, njoftohet Autoriteti i Konkurrencës për shqyrtimin e urdhrin të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, me nr.120 datë 23.8.2010 “Për dhënien e lejes për përdorimin e pasurisë së paluajtshme publike, aksit rrugor kombëtar, të përcaktuar sipas pikës 2 të lejes, shoqërisë ATU, për vendosjen e rrjetit privat të fibrave optike me kundërshpërblim dhe me destinacion përdorimi ekskluziv, mënyrë menaxhimi dhe mirëmbajtjeje” dhe marrjen e vendimit përkatës.

3. Me këtë vendim të njoftohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Inovacionit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

5. Kundër vendimit të mësipërm mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni. Ankimimi ndaj vendimit të mësipërm nuk pezullon ekzekutimin e këtij vendimi.

KRYETARI
Nasip Naço

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin 1996 (1134), datë 7.10.2011, ka vendosur shpalljen të vdekur të shtetasit Evangjellos Feno Bineri, i datëlindjes 2.6.1996.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 31.10.2011
Doli nga shtypi më 1.11.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 56 lekë